



DREJTUESIT



KRYETARJA Gjykatëse Ekaterina Trendafilova (Bullgari)

Kryetari i Dhomave të Specializuara të Kosovës është përgjegjës për administrimin gjyqësor të Dhomave të Specializuara dhe për funksione të tjera që i akordon Ligji. Kryetari përfaqëson Dhomat e Gjykatësve. Një nga detyrat kryesore të Kryetarit është caktimi i gjykatësve nga Regjistri i Gjykatësve ndërkombëtarë në përbërje të një paneli dhe në çështje gjyqësore para Dhomave të Specializuara. Kryetari i Dhomave të Specializuara kryen njëkohësisht detyrën e kryetarit të panelit të Gjykatës Supreme në çështjet ku merr pjesë.

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova u emërua Kryetare më 14 dhjetor 2016 dhe e filloi detyrën më 12 janar 2017. Ajo u rimërua për një mandat katërvjeçar në vitin 2020 dhe 2024. Kryetare Trendafilova, e cila më parë ka shërbyer si gjykatëse në Gjykatën Penale Ndërkombëtare (2006-2015), është një gjykatëse, juriste dhe akademike e shquar me përvojë të madhe në fushën e të drejtës penale ndërkombëtare, të drejtës dhe procedurës penale dhe të drejtës për të drejtat e njeriut.



ADMINISTRATORJA Dr. Fidelma Donlon (Irlandë)

Administratori është përgjegjës për administrimin e DHSK-së dhe ZPS-së. Gjithashtu, ai është në krye të shërbimeve mbështetëse gjyqësore. Administratori është përgjegjës për funksione të nevojshme të procedurave para DHSK-së, si mbrojtja, pjesëmarrja e viktimave, paraburgimi, mbrojtja dhe mbështetja e dëshmitarëve si dhe është në krye të njësive të tjera mbështetëse, si njësia juridike, njësia për administrimin gjyqësor, njësia e shërbimeve gjuhësore, njësia e informimit dhe e komunikimit me publikun dhe administrata. Administratori gjithashtu administron subvencionin e drejtpërdrejtë të BE-së, nëpërmjet të cilit financohet buxheti i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

Dr Fidelma Donlon u emërua Administratore në prill të vitit 2016 dhe u rimërua për një mandat katërvjeçar në prill të vitit 2020 dhe në prill të vitit 2024. Si administratore e lartë gjyqësore e sprovuar dhe akademike dhe juriste e respektuar, dr. Donlon ka shërbyer në Gjykatën Speciale për Sierra Leonen, në Gjykatën për Krime të Luftës të Bosnjë-Hercegovinës dhe Zyrën e Përfaqësuesit të Lartë në Bosnjë-Hercegovinë. Që nga viti 2015, ajo gjithashtu drejtoi themelimin strategjik dhe organizativ të Dhomave të Specializuara të Kosovës.



Gjykatësit u emëruan në Regjistër më 7 shkurt 2017 nga Autoriteti Emërues, pas rekomandimit të një paneli të pavarur përzgjedhës të Gjykatësve Ndërkombëtarë. Më 22 shtator 2020 u emëruan gjashtë gjykatës. Një gjykatës u emërua më 6 qershor 2024, një tjetër më 3 dhjetor 2024 dhe një gjykatës tjetër më 11 shtator 2025. Gjykatësit janë fizikisht të pranishëm në Dhomat e Specializuara vetëm sipas nevojës, me kërkesë të Kryetares së

GJYKATËSIT

Dhomave të Specializuara, për ushtrimin e detyrave të caktuara. Dhomat pasqyrojnë çdo nivel të sistemit gjyqësor të Kosovës dhe përbëhen prej paneleve në vijim: gjykatës individualë të cilët kryejnë detyrat e gjykatësit të procedurës paraprake; trupa gjykues të përbërë prej tre gjykatësish (dhe një gjykatësi rezervë); panele të Gjykatës së Apelit të përbëra prej tre gjykatësish; panele të Gjykatës Supreme të përbëra prej tre gjykatësish; panele të Gjykatës Kushtetuese të përbëra prej tre gjykatësish; dhe gjykatës individual të tjerë të nevojshëm për kryerjen e funksioneve të Dhomave të Specializuara.

Në përputhje me Ligjin për themelimin e Dhomave të Specializuara, gjykatësit janë të pavarur në kryerjen e detyrave të tyre dhe nuk marrin e as kërkojnë udhëzime prej asnjë qeverie ose burimi tjetër.

GJYKATËSIT NDËRKOMBËTARË TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS



Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetarja (Bullgari)



Gjykatës Çarls L. Smith, III
Nënkryetari (Shtetet e Bashkuara të Amerikës)



Gjykatës Vidar Stensland
Gjykata Kushtetuese (Norvegji)



Gjykatës Rumen Nenkov
Gjykata Kushtetuese (Bullgari)



Gjykatësi Pjotër Hofmanski
Gjykata Kushtetuese (Poloni)



Gjykatëse Romina Inkuti
Gjykata Kushtetuese -
Gjykatëse Rezervë (Itali)



Gjykatëse Kristinë van den Vajngart
(Belgjikë)



Gjykatëse Mireille Pekar
(Francë)



Gjykatës Tomas Laker
(Gjermani)



Gjykatës Emilio Gati
(Itali)



Gjykatës Roland Dekers
(Holandë)



Gjykatës Antonio Balsamo
(Itali)



Gjykatës Kai Ambos
(Gjermani)



Gjykatëse Mapi Feld-Folia
(Holandë)



Gjykatës Kristof Barte
(Gjermani)



Gjykatës Vladimir Mikula
(Çekia)



Gjykatës Gérald Metro
(Zvicër)



Gjykatës Zilber Biti
(Francë)



Gjykatës Daniel Fransen
(Belgjikë)



Gjykatës Fergal Gejnor
(Irlandë)



Gjykatëse Nina Jorgensen
(Norvegji)



Gjykatëse Marzhori Masëlo
(Francë)



Gjykatësi Kristofer Gosnel
(Kanada)

Për informacion më të gjerë, si dhe për jetëshkrimet e të gjithë gjykatësve të Dhomave të Specializuara të Kosovës,
ju lutemi vizitoni www.scp-ks.org